

## Sa do të kushtojë leja e legalizimi?

Aplikuesit të cilët i plotësojnë kushtet për leje legalizimi duhet të paguajnë taksën administrative të cilën komuna e aplikon aktualisht për leje të ndërtimit. Aplikuesit gjithashtu duhet të paguajnë taksat e papaguara të pronës para se të marrin lejen e legalizimit.

## Cilat ndërtime lirohen nga pagesa e taksës për legalizim?

Ndërtimet në vijim lirohen nga taksa për legalizimi: shtëpitë individuale të banimit deri në 100 m<sup>2</sup>, përfutjesit e skemave sociale, dhe objektet bujqësore deri në 400 m<sup>2</sup>.

## A duhet të aplikojnë për legalizim ndërtimet që lirohen nga taksa për legalizim, dhe cilat dokumente kërkohen?

PO!

Së pari duhet të regjistrohet ndërtimi pa leje në Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje. Aplikacioni për legalizim duhet pastaj të kompletohet dhe dorëzohet siç përshkruhet më sipër.

## Cilat ndërtime do të rrënohen sipas Ligjit?

Ndërtimet pa leje të cilat nuk janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje deri me 5 shkurt 2015;

Ndërtimet që janë të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje por që nuk kanë aplikuar për Legalizim – Faza e aplikimit;

Ndërtimet që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligj;

Ndërtimet që nuk i plotësojnë kërkesat themelore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në UA 18/2014;

Ndërtimet pa leje të cilave ju ka refuzuar Leja e Legalizimit;

## DATA TË RËNDËSISHME:

### 30 gusht 2013

data e hartës digjitale ortofoto. Ligji trajton çdo ndërtim të përfunduar, substancialisht të përfunduar ose të pa përfunduar para kësaj date.

### 5 shkurt 2014

data kur Ligji ka hyrë në fuqi.

### 5 shkurt 2015

data kur Komunitetet përfundojnë regjistrimin e ndërtimeve pa leje.

### 11 mars 2015

dita e publikimit të regjistrit shtetëror të ndërtimeve pa leje, aplikuesi duhet të verifikoj nëse ndërtimi i tyre është regjistruar dhe të informojë Ministrinë për ndonjë gabim ose lëshim eventual.

### 16 shtator 2015

fillimi i aplikimit për legalizim

### 16 mars 2016

fundi i aplikimit për legalizim

### 5 shkurt 2017

data në të cilën ligji pushon të jetë në fuqi.

Për më shumë informacion shihni faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

[www.mmph-rks.org](http://www.mmph-rks.org)

Ose kontaktoni Ministrinë në:

Ish- ndërtesa e mediave "Rilindja"

10 000 Prishtinë - Kosovë.

Tel: + 381 (0) 38 200 32 645



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornong Planiranja  
Ministry of Environment And Spatial Planning*

## SI TË PAJISEM ME LEJE TË LEGALIZIMIT?

Kjo broshurë është hartuar nga MMPH për të ofruar udhëzime për regjistrimin e ndërtimeve pa leje dhe se si të aplikohet për legalizimin e ndërtimeve pa leje



**LEGALIZO NDËRTIMIN**



## DISA PËRKUFIZIME TË LIGJIT PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE [LIGJI]

### Ndërtim pa leje

ndërtim ekzistues që është ndërtuar i cili ekziston në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas dëshmimeve të hartës digjitale ortofoto (një foto ajrore e Kosovës);

### Ndërtimi i përfunduar ose substancialisht i përfunduar

është ndërtim pa leje i cili ekziston në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa Leje sipas dëshmimeve të hartës ortofoto digjitale të datës 30 gusht 2013, në të cilën janë kryer punët ndërtimore, instalimet dhe të njëjtat paraqesin tersi ndërtuese të cilat mund të përdoren;

### Regjistri kombëtar i ndërtimeve pa leje

listë e nivelit qendror e të gjitha ndërtimeve pa leje në Kosovë;

### Lista e Rrënimit

listë e përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e atyre ndërtimeve pa leje të shënuara në Regjistrin kombëtar të ndërtimeve pa leje, por për të cilat nuk janë dorëzuar aplikacione për legalizim. Lista e Rrënimeve duhet të përfshijë të gjitha ndërtimet që janë subjekt i rrënimit pa marrë parasysh nëse rrënimi do të bëhet nga ana e Ministrisë apo Komunave.

### KUR KA HYRË LIGJI NË FUQI?

Ligji ka hyrë në fuqi më **5 shkurt 2014** dhe do të jetë në fuqi për tre vite, deri më **5 shkurt 2017**.

### Pse kam nevojë për leje legalizimi?

Ndërtimi juaj behet i ligjshëm dhe i sigurt për banim;  
Kaloni hapin e parë të regjistrimit të ndërtimit tuaj në Kadastër;  
Ndërtimi juaj mund të shërbej si hipotekë për marrje të kredive nga Bankat;  
Komuna juaj do të planifikon dhe ofron shërbime për të cilat keni nevojë;  
Nuk shqetësoheni se ndërtimi juaj do të rrënohet;



**NËSE NUK E REGJISTRONI NDËRTIMIN PA LEJE DO TË HUMBNI MUNDËSINË E LEGALIZIMIT!**

### Cilat ndërtime trajtohen sipas këtij Ligji?

Të gjitha ndërtimet e përfunduara ose substancialisht të përfunduara që janë identifikuar në hartën digjitale ortofoto të datës 30 gusht 2013 në Kosovë, ose sigurojnë dëshmi se ndërtimi ka ekzistuar para datës 30 gusht 2013.

Ndërtimet e papërfunduara që janë identifikuar në hartën digjitale ortofoto të datës 30 gusht 2013 trajtohen sipas Ligjit të Ndërtimeve pa Leje dhe të Ligjit të Ndërtimit.

### Çfarë do të ndodhë me ndërtimet e ndërtuara pas 30 gushtit 2013 të cilat nuk janë përfshirë në hartën digjitale ortofoto?

Ndërtimet e papërfunduara që nuk janë identifikuar në hartën digjitale ortofoto të datës 30 gusht 2013 trajtohen sipas Ligjit të Ndërtimit dhe Ligjit të Planifikimit Hapësinor.

### Kur dhe si të aplikoni për regjistrim në Regjistrin e Ndërtimeve pa Leje?

Aplikimet për regjistrimin e ndërtimeve pa leje të ndërtuara para 30 gushtit 2013 do të regjistrohen deri më 5 shkurt 2015.

Kërkesën-formularin për tu listuar në Regjistrin e Ndërtimeve pa Leje mund ta shkarkoni nga faqja e internetit e komunës tuaj dhe Ministrisë. Ju gjithashtu mund të merrni formularin personalisht në komunën tuaj. Ky formular duhet të dorëzohet në Komunë.

### Kur dhe si të kem qasje në Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje?

Qytetaret të cilët kanë ndërtime pa leje ose njësi brenda ndërtimeve pa leje janë të obliguar të deponojnë kërkesë për tu përfshirë në Regjistrin Komunal të ndërtimeve pa leje, njëkohësisht edhe Komuna e bene identifikimin e të gjitha ndërtimeve pa leje duke i listuar ato në Regjistrin Komunal të Ndërtimeve pa Leje.

Me 11 mars 2015 Ministria publikon Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje. Aplikuesi është përgjegjës për të verifikuar se ndërtimi i tyre është përfshirë në listë ose për të informuar Ministrinë për çfarëdo gabimi apo lëshimi eventual.

### Kur dhe ku duhet të aplikoni për leje legalizimi?

Aplikacionet për legalizim mund të paraqiten brenda gjashtë muajve pas publikimit të Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje.

Nëse keni nevojë për të aplikuar për legalizimin e një shtëpie banimi individual apo të një ndërtesë të banimit kolektiv, ju duhet të aplikoni në komunën në të cilën gjendet ndërtimi pa leje.

Për kategoritë I dhe II të ndërtimeve (me rrezik të ulët dhe të mesëm, siç përcaktohet në nenin 15 të Ligjit për ndërtim), aplikacionet duhet të dorëzohen në komunë. Për kategorinë III (me rrezik të lartë dhe / ose me interes kombëtar), aplikacionet duhet të dorëzohen në Ministri.

### Si të aplikoj?

Një formë standarde gjendet në faqen e internetit në komunën tuaj dhe faqen e internetit të Ministrisë. Ju gjithashtu mund të merrni një formë në komunën tuaj.

Ju duhet të plotësoni formularin dhe ta dorëzoni atë së bashku me dokumentet e kërkuara dhe dëshminë për taksën prej njëqind (100) euro të paguar.

Vetëm aplikacionet e kompletuara do të shqyrtohen. Prandaj, ju duhet të siguroheni që të gjitha dokumentet e kërkuara sipas nenin 10 të Ligjit janë dorëzuar.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment And Spatial Planning*

## **LEGALIZO NDËRTIMIN, Shfrytëzo rastin!**

Trajtimi i Ndërtimeve pa Leje ka filluar!

Nëse ke ndonjë ndërtim (shtëpi, banesë, lokal,...) pa leje, shfrytëzo rastin legalizojë!

Regjistrimi i ndërtimeve pa leje mund të bëhet vetëm deri me **5 Shkurt 2015!**

Regjistrimi është **FALAS!**

Plotëso **FORMULARIN E REGJISTRIMIT** dhe dorëzoje në Komunën tënde

### **5 Arsye pse duhet ta legalizosh ndërtimin pa leje**

1. Ndërtimi juaj behet i ligjshëm dhe i sigurt për banim
2. Kaloni hapin e parë të regjistrimit të ndërtimit tuaj në Kadastër
3. Ndërtimi juaj mund të shërbej si hipotekë për marrje të kredive nga Bankat
4. Komuna juaj do të planifikon dhe ofron shërbime për të cilat keni nevojë
5. Nuk shqetësoheni se ndërtimi juaj do të rrënohet

### **Mbani mend!**

**Nëse nuk e regjistroni ndërtimin pa leje tani, do të humbni mundësinë e legalizimit!**

Regjistrimi është hapi i parë i procesit të legalizimit të ndërtimit pa leje, detajet tjera mbi këtë proces mund t'i gjeni në fletushkën e bashkangjitur si dhe Formularin e Regjistrimit.

**REGJISTRO NDËRTIMIN PA LEJE!**

**SHTOJCA 1.****KËRKESË PËR T'U LISTUAR NË REGJISTRIN E NDËRTIMEVE PA LEJE****KËRKESË PËR T'U LISTUAR NË REGJISTRIN E NDËRTIMEVE PA LEJE**

INFORMACIONE MBI PARCELËN KADASTRALE		
NR. PARCELËS	KOORDINATAT GPS	NR. REFERENCËS
KOMUNA	ZONA KADASTRALE	

APLIKUESI			
EMRI	EMRI I BABËS	MBIEMRI	TEL:
ADRESA:			EMAIL:
PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR I APLIKUESIT (nëse ka)			
EMRI	EMRI I BABËS	MBIEMRI	TEL:
ADRESA			EMAIL:

A është aplikuesi pronar i regjistruar i parcelës?  Po  Jo

PRONARI I REGJISTRUAR I PARCELËS (nëse është i ndryshëm nga aplikuesi)			
EMRI	EMRI I BABËS	MBIEMRI	TEL:
ADRESA			EMAIL:

LLOJI I NDËRTIMIT
<input type="checkbox"/> Shtëpi <input type="checkbox"/> Ndërtesë në Bashkëpronësi <input type="checkbox"/> Ndërtim Komercial <input type="checkbox"/> Ndërtim Industrial <input type="checkbox"/> Mbindërtim
<input type="checkbox"/> Tjetër _____
A është përfunduar ndërtimi? <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
A është i përfshirë ndërtimi në Regjistrin e Tatimit në Pronë? <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
A ka marrë ndërtimi aprovimin për ofrimin e shërbimeve publike? <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo